



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 7173/Prot.
6

Tiranë, më 27.01. 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 07, datë 27.01. 2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje nenit 78/1/a të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "ALIAJ-79" shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, për qëllime kualifikimi, në procedurat e prokurimit me objekt: "*Blerje bazë materiale hidraulike dhe ndërtimi*" me fond limit 1.493.862 lekë pa tvsh dhe "*Blerje materiale e pajisje të ndryshme ndërtimi*", me fond limit 2.333.333 lekë pa tvsh, të zhvilluara nga autoritetet kontraktore Ujësjetës Kanalizime Mat dhe Bashkia Mat, respektivisht në datë 18.03.2021 dhe në datë 17.05.2021.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP").

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Aliaj-79" Shpk, me NIPT L47521901E, me adresë: Lis, Zenisht, Rruga "Ruçi", Ndërtesë private përballë xhamisë, Dibër.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "ALIAJ-79" shpk, ka nisur nga raportimet periodike të informacioneve dy palëshe ndërmjet APP dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në vijim "ISHPSHSH"), ku ka rezultuar se, ky subjekt në datë 18.03.2021 dhe në datë 17.05.2021 të zhvillimit të procedurave të mësipërme të prokurimit, rezulton të ketë patur në fuqi masën administrative gjobë, të palikujduar, sipas shkresës së dërguar nga ISHPSHSH.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit, për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP, në dy procedurat e prokurimit të sipërcituara.

III. Masat:

me Vendimin Nr.07 datë 27.01.2022, APP ka vendosur të përjashtojë për 10 (dhjetë) muaj operatorin ekonomik "ALIAJ-79" shpk me NIPT L47521901E nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese për operatorin ekonomik "ALIAJ-79" shpk, vlerën e fondit limit dhe faktin se, ka keqinformuar, por nuk ka ndërhyrë në dokumentet e paraqitur në tender, si dhe nuk ka precedentë të mëparshëm për përjashtim nga e drejta për të fituar kontrata publike.

Si rrethanë rënduese mbahet në konsideratë fakti që, operatori "Aliaj-79" Shpk është shpallur fitues dhe ka nënshkruar kontratat në këto dy procedura prokurimi, duke përfituar fonde publike.